



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr. 1, datë 24/2/2022

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIIT TË LEJES “PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT NËNTOKËSOR”, SHOQËRISË “...TE BIRRA STELA” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm.

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor, subjektit “Te Birra Stela” sh.p.k., me vendndodhje Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e pus-shpimit ekzistues (koordinatat e gabuara në KRGJSH):

- X=478642.662
- Y=4580135.409
- Z=56 m.m.n.d

Vendndodhja e pus-shpimit në përdorim (koordinatat e sakta në KRGJSH):

- X=478861.95
- Y=4580237.90

Prurja e kërkuar Q = 1 l/s

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ISHËM

ROLAND NASTO

